



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 02, dt. 13.03.2019

**MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA
NGA VITI 2018**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2019, si dhe të akt rakordimit përfundimtar me Degën e Thesarit mbi përdorimin e fondeve të vitit 2018, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e të ardhurave të trashëguara nga viti 2018 në vlerë 28129291 leke.
2. Të miratojë shtesë në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2019 të të ardhurave të trashëguara në vlerë 28129291 lekë sipas pasqyres bashkangjitur.
3. Fondi prej 28129291 lekë do të përdoret në zërat e buxhetit si me poshtë:
- “Bashkëfinancim në Projekte të Bashkimit Europian” 28129291 lekë
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e finances, zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve në Këshillin e Qarkut, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi L.Pleqi
Juristi Gj. Kristo
Sekretar i K.Qarkut B.Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT KORÇE
Drejtoria e Finances, Zhvillimit Ekonomik dhe Sherbimeve

RELACION
MBI MIRATIMIN E PERDORIMIT TE TE ARDHURAVE TE TRASHEGUARA NGA VITI
2018

Ne mbeshetje te Ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vndore", Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", Ligjit "Per buxhetin e vitit 2019" si dhe te Vendimit te Keshillit te Qarkut nr. 13 date 11.12.2018 "Mbi miratimin e buxhetit te Keshillit te Qarkut per vitin 2019" ju paraqitim per miratim perdorimin e te ardhurave te trasheguara nga viti 2018.

Ne baze te akt rakordimit perfundimtar me Degen e Thesarit Korce mbi perdorimin e fondeve te buxhetit te vitit 2018, Keshilli I Qarkut ka trasheguar fonde te paperdura ne vlere totale 73288777.1 leke. Trashegimi I ketij fondi nga viti 2018 ka ardhur ne disa zera te cilat jane analizuar ne miratimine buxhetit te vitit 2019. Rreth 66% ose 48.4 milion leke jane trasheguar nga fondet e planifikuara per bashkefinansim per pjesemarje ne projektet e Bashkimit Europian. Gjate vitit 2018 Keshilli I Qarkut ka nenshkruar kontratat per pjesemarje ne kater projekte te fituara me fonde te Bashkimit Europian me vlere totale 1050 mije euro, nga te cilat dy projekte strategjike dhe ne dy projekte te vogla. Implementimi I tyre filloi gjate vitin 2018 por financimi do te vashdoje gjate 2019 dhe ne vazhdim. Kjo ishte edhe arsya e mosperdorimit te ketyre fondeve, te cilat jane trasheguar ne te njejtin ze buxheti. Trashegim te fondeve kemi edhe ne zerin investime me rreth 15.8 milion leke, te planifikuara keto per tu perdorur ne momentin e levizjeve te institucionit ne ambjentet e bashkise si dhe ne investimet qe po realizohen ne bashkite e qarkut dhe do te financohen gjate vitit 2019. Gjithashtu trashegim kemi edhe ne zerin shpenzime operative me rreth 5.4 milion leke te planifikuara keto per financimin e detyrimeve ne shpenzime operative te trasheguara ne vite si per Keshillin e Qarkut edhe per ndermarjet e varesise si dhe per vendime gjyqesore te formes se prere, por qe per shkak te vendosjes se limitit te cashit per 2/mujorin e fundit, kane filluar te financohen ne periudhen ne vazhdim.

Nga fondi I trasheguar ne total prej 73288777 leke, fondi prej 45159486 leke eshte planifikuar per tu perdorur qe ne miratimin e buxhetit te vitit 2019. Pjesa e mbetur prej 28129291 leke propozojme te perdoret e ndare si me poshte:

- Bashkefinansim ne Projekte te Bashkimit Europian 28129291 leke
Planifikimi I ketij fondi per tu perdorur ne kete ze lidhet me faktin e nevojës per parafinancim ne te kater projektet qe jane ne fazen e implementimit. Parafinancimi shkon deri ne 20 % te vleres se projekteve qe ne total shkon ne rreth 200 mije euro. Kjo vlere do ti rikthehet buxhetit te Keshillit te Qarkut mbas disbursimit te fondeve nga Bashkimi Europian sipas procedurave te miratuara ne Mareveshje te perbashketa midis Qeverise Shqiptare dhe Bashkimit Europian.

Korce me 01.03.2019

Liljana PLEQI
Drejtore e Finances